



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 29, datë 06.03.2024

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.61, DATË 28.02.2023, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH, OBJEKTET E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar me Urdhërin nr. 222, datë 06.07.2020, Raportit me nr. 2712/1prot., datë 26.02.2024 të Komisionit të Posaçëm si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 11, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 28.02.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë



Administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar, përkatësisht për subjektet si më poshtë vijon:

Nr.	NR. TAB	NR. RENDOR	PRONARI	ZONA E RE PËR ZHVILLIM E MIRATUAR	ZONA E RE PËR ZHVILLIM E NDRYSHUAR
1	2	2	RAHMI HYSI	ZONA RE PËR ZHVILLIM NR.4	ZONA RE PËR ZHVILLIM MANËZ
2	4	5	VERA ELEZI	ZONA RE PËR ZHVILLIM NR.4	ZONA RE PËR ZHVILLIM MANËZ
3	4	9	SABRIJE KOTOBELLI, MURAT KOTOBELLI, VITRIJE KOTOBELLI, GEZIM KOTOBELLI, KRESHNIK KOTOBELLI, XHEVAIR KOTOBELLI, NAILE KOTOBELLI	ZONA RE PËR ZHVILLIM NR.4	ZONA RE PËR ZHVILLIM MANËZ
4	4	14	LIRIM MEDOLLI, VIKTORE MEDOLLI, GAZMEND MEDOLLI, LIRJANA MEDOLLI, BAJAME MEDOLLI	ZONA RE PËR ZHVILLIM NR.4	ZONA RE PËR ZHVILLIM MANËZ
5	5	10	SYBI NANUSHI, AFERDITA NANUSHI, ILIRJAN NANUSHI, DRITAN NANUSHI	ZONA RE PËR ZHVILLIM NR.4	ZONA RE PËR ZHVILLIM MANËZ

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 07.03.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 162 prot.
15

Durrës, më 13.03.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.29 datë 06.03.2024 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.61, datë 28.02.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative Sukth, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

